

URDHËR
Nr.132, datë 8.3.2020

**PËR MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE
ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO
TË HAPURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat “b” dhe “c”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, vendimit të datës 8.3.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike të tilla si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, deri në datën 3 prill 2020.
2. Anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, deri në datën 3 prill 2020.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë strukturat përgjegjëse për organizimin e veprimtarive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu